

VENDIM
Nr.858, datë 5.8.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË
LARTË UNIVERSITARE “ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare, private “Zoja e Këshillit të Mirë” të programit të studimit “Master i nivelit të parë”, për “Menaxhim për funksionet e koordinimit”.

2. Programi i studimit “Master i nivelit të parë” do të jetë program studimi i ciklit të dytë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të tij lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP), në “Menaxhim për funksionet e koordinimit”.

3. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare, private “Zoja e Këshillit të Mirë”, të programeve të studimit “Master i nivelit të dytë”, në:

- a) Qeverisje dhe zhvillim territorial;
- b) Organizim e drejtim i institucioneve dhe i shërbimeve shëndetësore;
- c) Ortodonci;
- ç) Implantologji dhe proteza dentare.

4. Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” do të jetë program studimi të ciklit të tretë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të tyre lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), përkatësisht, në:

- a) “Qeverisje dhe zhvillim territorial”;
- b) “Organizim e drejtim i institucioneve dhe i shërbimeve shëndetësore”;
- c) “Ortodonci”
- ç) “Implantologji dhe proteza dentare”.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private “Zoja e Këshillit të Mirë”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

6. Shkolla e lartë universitare, private “Zoja e Këshillit të Mirë” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Shkolla e lartë universitare, private, “Zoja e Këshillit të Mirë” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha